

VENDIM

“PËR CAKTIMIN E MASËS SË SIGURIMIT PASUROR, SEKUESTRO PREVENTIVE”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtar: Elona STAVRI

asistuar prej sekretares **Emona KORA**, sot më datë 28.04.2016, përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të përfaqësuar nga prokurori **Elfrida Bregova** për caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive llogari bankare ndaj pasurive të,

Personat nën hetim: **L. M.** e bija e H. dhe Z., dtl. 26.07.19.., lindur ne Kucove dhe banuese ne Tirane, me kombësi e shtetësi shqiptare.

A. M., e bija e E. dhe e L. ,e datëlindjes 01.08.19.., lindur në Tirane e banues në Tiranë, me kombësi e shtetësi shqiptare.

K. Rr. i biri i S. dhe N., dtl. 23.05.19.., lindur dhe banues ne Librazhd, Lagjia ..., pll. ..., shk. ..., beqar, arsimi i larte, kombesi-shtetesi shqiptare,

Te hetuar për: Kryerjen e veprës penale të “Mashtimit”, të parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor prokurori kërkoi vendosjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive mbi llogarite bankare ne te gjitha bankat qe operojne brenda territorit Shqiptar ne emer te shoqerise “A... - L..” shpk bazuar ne nenin 274/1/2 të Kodit te Procedures Penale.

Pas shqyrtimit të provave të paraqitura, gjykata:

VËREN:

Se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurori ka paraqitur kërkesën për vendosjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive te llogarive bankare, të parashikuar nga neni 274/1/2 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj pasurive të “A... - L..” shpk.

Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës penale objekt gjykimi, gjykata analizoi kryesisht juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e kësaj çështje. Në bazë të neneve 13§2, 69, 74, 76 dhe 278 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata konstatoi se çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore e tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Nga parashtrimi i prokurorit në seancë gjyqësore rezultoi se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë më datë 26.04.2016, ka regjistruar procedimin penal nr.3534, për veprën penale të “Mashttrimit” me pasoja te renda, të parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetas A. M., L. M. dhe K. Rr..

Nga veprimet hetimore të kryera nga prokuroria ka rezultuar se në datën

25.05.2016 në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë janë paraqitur dhe kanë

bërë kallëzim shtetasit E. J., M. K., F. M., A. D., B. L., L. L., T. A., A. Sh., P. V.,

D. M., G. P., G. Sh., M. M., D. T., F. Ll., P. H., A. Z., Dh.A., Sh. H., Sh. Q., L. C.,

B. B., K. D., S. Z., M. A., B. I..Këta shtetas në kallëzimin e tyre kanë shpjeguar

se kanë aplikuar në vitin 2014, për punësim dhe studime pranë shoqërisë

“A...-L...” Sh.P.K me administratore shtetasen L. M. që ndodhet me seli në

rrugën “...” Tiranë që të pajiseshin me viza studimi apo punësimi në Kanada,

Angli, Australi etj. Pas kontaktit që keta shtetas merrnin me shtetasen L. M.

ajo ju premtonte se shumë shpejt do të pajiseshin me vizë, dhe per këtë fakt

të kryenin pagesat në bankë, për llogari të firmës A... - L.. shpk.

Shtetasit që kanë aplikuar dhe kanë dorëzuar dokumentat për pajisjen

me vizë, kanë paguar në llogari të shoqërisë “A... - L..” Sh.P.K, shuma te

konsiderueshme në lekë dhe valutë, në banka të ndryshme që operojnë në territorin Shqiptar.

Pasi kanë shkuar në datë 25.04.2016 pranë zyrave të kësaj shoqërie kanë mësuar se shtetasja L. M. së bashku me vajzën e saj A. M. ishin larguar jashtë shtetit, dhe se në administrim këtë shoqëri i'a kishin lënë shtetasit K. Rr. i cili është prezantuar se e kishte blerë ai këtë shoqëri dhe do i ndiqte ai procedurat për aplikantet që kishin bërë aplikimin dhe për personat që do të aplikonin.

Nga veprimet hetimore të kryera nga prokuroria ka rezultuar se shtetasja L. M. është administatore dhe ortakë e vetme e shoqërisë "A... - L.."shpk me status aktiv dhe e rregjistruar me Vendimin nr.... date ... te Gjykeses se Rrethit Gjyqesore Tirane. Me objekt te aktivitetit te saj "Agjensi Sherbimesh" dhe me adrese te selise Rruga "... " Pall nr...., shkalla 1, Kati 3 Tirane. (te dhena te nxjerra nga ekstrakti historik i QKR date 27.04.2016)

Nisur nga sa më lart, duke qënë se shumtat e paguara në banka të ndryshme për llogari të shoqërisë dyshohet se janë pasuri e përfituar nga kryerja e veprës penale të dyshuar, produkt i saj, si dhe ka rrezik që disponimi i lirë i kësaj pasurie mund të rëndojë se të zgjasë pasojat e veprës si dhe lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, është e domosdoshme që të kryhet sekuestroja preventive .

Në mbështetje të kërtimeve të tij prokurori i paraqiti gjykatës aktet që vërtetojnë kryerjen e veprimeve të mesiperme.

Në lidhje me sa më sipër, në nenin 274/1/2 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet shprehimisht se:

“1. Kur ka rrezik qe disponimi i lire i nje sendi qe lidhet me vepren penale mund te rendoje ose te zgjase pasoja ose te lehtësoje ne kryerjen e vepres penale te tjera, me kerkesen e prokurorit, Gjykata kompetente urdheron sekuestrimin e tij me vendim te arsyetuar.

Sekuestroja mund te vendoset edhe per sendet ,produktet e vepres penale dhe cdo lloj pasurie tjeter qe lejohet te konfiskohet,sipas nenit 36 te Kodit Penal”

Ne vleresim te kerkeses se prokurorit Gjykata analizoi ekizstencen e dy elementeve te nevojshem ne vendosjen e mases se sigurimit pasurore sekuestron preventive ate te “*fumus commmissi delicti*”, dhe “*periculum in mora*”.

Ne nenin 228 te Kodit te Procedures Penale percaktohet se “*Askush nuk mund tu nenshtrohet masave te sigurimit personal ne qoftese ne ngarkim te tij nuk ekziston nje dyshim i arsyeshem i bazuar ne prova*”.

Ne kontekst te provave Gjykata konstaton se nga analiza ne unitet i tyre ekziston dyshimi i arsyeshme se personi nenhetim duke vepruar ne kundershtrim te plote me aktet rregullative statuore te Shoqerise dhe duke perfituar nga transaksionet *mala fede* me te tretet me cilesine e ortakut te vetem ka kryer vepren penale te parashikuar nga neni 143/2 te Kodit Penal.

Ne lidhje me analizen e elementit te dyte te nevojshme *periculum in mora* Gjykata konstaton se ajo kerkon nevojen e evitimit te rrezikut qe shkakton disponimi i lire i sendeve qe lidhen me vepren penale te cilat mund te rendojne ose te zgjasin pasojat e saj. Ne kete kuader Gjykata konstaton se pasurite e luajtshme perfaqesuar nga llogarite bankare te shoqerise perben ate *species* te sendit qe lidhet me vepren penale te dyshuar dhe ne kushtet kur individualizohet *ubi consistam* te lidhjes midis sendit dhe vepres penale te dyshuar si te tilla ato i nenshtrohen sekuestron preventive te parashikuar nga dispozitat ligjore te nenit 274 te Kodit te Procedures Penale.

Per keto arsye

Në këto kushte, mbështetur në sa u tha më lart dhe në bazë të neneve 112 dhe 274 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata:

VENDOSI:

- 1- Vendosjen e sekuestron preventive të llogarive bankare ne emer te shoqerise “A... - L..” shpk ne te gjitha Bankat e Nivelit te dyte që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

- 2- Ngarkohet prokuroria gjyqësore me marrjen e masave të shpejta për zbatimin e këtij vendimi.
- 3- U shpall sot më datë: 28.04.2016 në Tiranë.

S E K R E T A R E

G J Y Q T A R E

Emona KORA

Elona STAVRI